



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2148/1 Prot.

Tiranë, më 28/12 2018

VENDIM

Nr. 22, datë 27/12/2018

PËR

**PLOTËSIMIN E VENDEVE VAKANTE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL
ZGJEDHOR TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 2459/1 prot, datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 27.12.2018,

VENDOSI:

1. Të miratojë dorëheqjen e përfaqësuesit të studentëve në Komisionin Institucional Zgjedhor (KIZ), për shkak të përfundimit të studimeve.
2. Të miratojë largimin e përfaqësuesit të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF) në Komisionin Institucional Zgjedhor (KIZ) të Universitetit Politeknik të Tiranës, për shkak të daljes në pension.
3. Të shpallë vendet vakante për dy (2) anëtarë në Komisionin Institucional Zgjedhor.
4. Të shpallë kërkesën për aplikim për dy (2) anëtarë në Komisionin Institucional Zgjedhor të Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësues të studentëve dhe përfaqësues të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.
5. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregulloren e miratuar të MASR Nr. 2459/1 prot, datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

organet në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

6. Regjistrimi i kandidatëve të interesuar të bëhet në sekretarinë e Senatit Akademik (pranë Drejtorisë së Kërkimit Shkencor në Rektorat) brenda datës 11 janar 2019.
7. Ngarkohet Komisioni Institucional Zgjedor dhe Drejtoria e Kërkimit Shkencor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al